

Nr. 2304/35 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 25/04/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **DENONCIM Nr. 8** – Lidhur me
zhvillimin e veprimtarisë së
ndaluar nga KQZ-ja, prej
Bashkisë Tiranë, më datën
17.04.2023.

I Nderuar Z. Komisioner!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në vazhdimësi, **ju paraqesim më poshtë një denoncim të KRIIK në lidhje me zhvillimin e një aktiviteti, pavarësisht ndalimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.**

Me [Vendimin nr. 367 datë 15.04.2023](#) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndalimin e zhvillimit të tetë aktiviteteve të raportuara për t'u zhvilluar nga Bashkia Tiranë.

Vendimmarrja është bazuar në arsyetimin se “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktivitetet e raportuara nga institucioni publik, Bashkia Tiranë, me pjesëmarrjen e personave partiakë, në kuadër të fushatës zgjedhore, përbëjnë veprimtari të ndaluara, në kuptim të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Një prej aktiviteteve të ndaluara për t'u zhvilluar ishte edhe ai me temë [“Takim me Deputetët dhe Anëtarët e rinj të KB”](#), me vend zhvillimi: “Selia PS”, me datë zhvillimi 17.4.2023, ora 17:30. Ky ndalim është pasqyruar edhe [në ndërfagen e aktiviteteve të ndaluara](#) nga KQZ.

KRIIK angazhoi një monitorues i cili në ditën dhe orën e caktuar ishte prezent në selinë e PS për të monitoruar nëse takimi do të kryhej.

Pavarësisht se monitoruesit të KRIIK iu ndalua hyrja në selinë PS që të mund ta vëzhgonte drejtpërdrejt kryerjen e aktivitetit (megjithëse i pajisur me akreditimin si vëzhgues prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve), nga bisedat me persona të grumbulluar në hyrjen e selisë së PS ai mundi të konfirmonte se **aktiviteti u zhvillua pavarësisht ndalimit të vendosur nga KQZ.**

Për sa më sipër, **KRIIK denoncon me ashpërsi këtë sfidë të zbatimit të ligjit dhe Institucionit të KQZ-së, të disatën e këtij lloji.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, **KQZ-ja** nevojitet të tregojë ashpërsinë e ligjit ndaj atyre që e **sfidojnë atë**, nga njëra anë, si dhe **funksionalitetin e mekanizmit të ndërtuar** pas reformës zgjedhore të vitit 2020 **për të parandaluar abuzimin me burimet shtetërore**, nga ana tjetër.

Një qëndrim pasiv apo interpretues ndaj ligjit çon në anashkalimin e tij në vazhdimësi, siç e tregon më së miri ky rast i përsëritur i injorimit të vendimeve të KQZ-së prej zyrtarëve publikë, në favor të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Në gjykimin e KRIIK, **KQZ-ja** nevojitet të sanksionojë përpos titullarëve vendorë edhe subjektin zgjedhor **“Partia Socialiste e Shqipërisë”**, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet i ndaluar (neni 172 pika 1 e Kodit Zgjedhor).

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania